



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDIIMBIKËQYRJESPUBLIKE

KOMISIONIIPROVIMEVETËAFTËSIVEPROFESIONALE

31.03.2021

Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit

TEZA 5

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk përshkruan elementët apo synimet e qeverisjes së mirë të korporatave:
 - a. Mbikëqyrja e performancës së korporatës
 - b. Emërimi dhe vlerësimi i performancës së Bordit të Drejtorëve (Këshillit Drejtues)
 - c. Ndarja e përgjegjësisë midis qeverisjes dhe manaxhimit
 - d. Ndjekja e strategjisë së korporatës në mënyrë etike dhe sjellja transparente organizative
 - e. Përgjegjësia për mbrojtjen vetëm të të drejtave dhe interesave të aksionarëve
 - f. Ndershmëria dhe besueshmëria e raportimit financiar, si ai i brendshëm dhe ai i jashtëm
 - g. Manaxhimi i rrezikut, krijimi dhe vënia në funksion e sistemeve të kontrolleve të brendshme është thelbësore në qeverisjen e mirë
 - h. Tërheqja e investimeve të reja dhe rritja e besimit që tregjet kapitale kanë për kompaninë

Përgjigja e saktë është alternativa E

2. Vlerësimi i performancës së Bordit të Drejtorëve (Këshillit Drejtues) është një mënyrë e rëndësishme e ushtrimit të kontrollit mbi të, e cila ka për qëllim përmirësimin e efektivitetit të bordit, maksimizimin e pikave të forta dhe eliminimin e dobësive. Ky process, i cili duhet të ndodhë çdo vit, bazohet në një serë kriteresh vlerësimi.

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk përbën një ndër kriteret e vlerësimit për performancën e bordit?

- a. Performanca kundrejt objektivave
- b. Zhvillimi i strategjive të biznesit
- c. Menaxhimi efektiv i rreziqeve

- d. Përbërja e duhur e bordit dhe komiteteve
- e. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm
- f. Efektiviteti i komiteteve të bordit
- g. Manaxhimit efektiv i çështjeve operative të kompanisë
- h. Përmbyllja e kërkesave ligjore

Përgjigja e saktë është alternativa G

3. Pavarësisht rëndësisë në qeverisjen e korporatës, zbatimi i roli i drejtorëve jo – ekzekutivë sjell vështirësi të shumta, të cilat përfshijnë sa më poshtë, përveç:

- a. Drejtorët jo - ekzekutivë mund të mos jenë të pavarur
- b. Paragjykimet kundër rritjes së numrit të drejtorëve jo – ekzekutivë
- c. Drejtorët jo – ekzekutivë të kalibrit të lartë kanë interes të shërbejnë vetëm në kompanitë e mirë – manaxhuara
- d. Drejtorët jo - ekzekutivë jo gjithmonë arrijnë të imponojnë pikëpamjet e tyre tek bordi për shkak të mungesës së votës
- e. Koha që drejtorët jo – ekzekutivë mund t'i kushtojnë aganzhimit në bord mund të jetë e kufizuar për shkak të angazhimeve të tjera
- f. Drejtorëve jo - ekzekutivë nuk i jepet rëndësia e duhur për parandalimin e problemeve por pritët nga ta zgjidhja kur problemet dalin në pah
- g. Drejtorët jo – ekzekutivë mund të dëmtojnë performancën e kompanisë për shkak se ata mund të mbysin shpirtin sipërmarrës
- h. Të gjithë alternativat e mësipërme përbëjnë vështirësi në zbatimin e rolit të drejtorëve jo - ekzekutivë

Përgjigja e saktë është alternativa D

4. Nxitja është një objekt, situatë ose veprim që përdoret si një mjet për të ndikuar në sjelljen e një individi tjetër, por jo domosdoshmërisht me qëllimin për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në sjelljen e këtij individi. Cilat prej formave të mëposhtme mund të quhet nxitje

- a. Punësimi ose mundësi të tjera komerciale
- b. Trajtimi preferencial, të drejtat ose privilegjet
- c. Donacione politike ose bamirësie
- d. Joshjet për miqësi dhe besnikëri
- e. Alternativa a dhe c janë të sakta
- f. Alternativa b dhe d janë të sakta
- g. Të gjitha më lart janë të sakta
- h. Asnjë nga më lart

Përgjigja e saktë është alternativa G

5. Cila prej alternativave të mëposhtme është e sakte?

- a. Firma, anëtar i grupit të sigurisë apo një familjar i drejtpërdrejtë i këtij individi, duhet të pranojë një hua apo një garanci huaje nga një klient i sigurisë që është

një bankë apo institucion i ngjashëm, edhe pse huaja ose garancia nuk është bërë sipas procedurave.

- b. Firma, anëtari i grupit të sigurisë apo një familjar i drejtpërdrejtë i këtij individi, nuk duhet të pranojë një hua apo një garanci huaje nga një klient i sigurisë që është një bankë apo institucion i ngjashëm, vetëm nëse huaja ose garancia është bërë sipas procedurave, kushteve dhe termave normale të huadhënies
- c. Firma dhe anëtari i grupit të sigurisë nuk duhet të pranojë një hua apo një garanci huaje nga një klient i sigurisë që është një bankë apo institucion i ngjashëm, vetëm nëse huaja ose garancia është bërë me vullnetin e lire të paleve
- d. Firma nuk duhet të pranojë një hua apo një garanci huaje nga një klient i sigurisë që është një bankë apo institucion i ngjashëm, vetëm nëse huaja ose garancia është e kushtezuar sipas termave të shërbimit të angazhuar.
- e. Alternativa a dhe b janë të sakta
- f. Alternativa a dhe d janë të sakta
- g. Të gjitha më lart janë të sakta
- h. Asnjë nga më lart

Përgjigja e saktë është alternativa B

6. Ekzistenca e kushteve, politikave dhe procedurave gjithashtu mund të jenë faktorë të rëndësishëm gjatë vlerësimit të nivelit të kërcënimeve për pajtueshmërinë me parimet themelore. Shembuj të kushteve, politikave dhe procedurave të tilla përfshijnë:

- a. Kërkesat e qeverisjes së korporatave
- b. Kërkesat për edukimin, trajnimin dhe eksperiencën, që duhet të plotësohen për të hyrë në profesion
- c. Sisteme efektive të ankesave që mundësojnë profesionistin kontabël dhe publikun e gjerë të tërheqë vëmendjen ndaj sjelljes joetike.
- d. Një detyrim i shprehur në mënyrë të qartë për të raportuar shkelje të kërkesave të etikës.
- e. Monitorimi profesional dhe rregullator
- f. Procedurat disiplinore
- g. Të gjitha më lart janë të sakta
- h. Asnjë nga më lart

Përgjigja e saktë është alternativa G

7. Një shenjë që e dallon profesionin kontabël në mbarë botën është pranimi i përgjegjësisë për të vepruar në interes të:

- a. publikut
- b. nevojave të klientit
- c. organizatës profesionale
- d. ushtrimit të profesionit kontabël

Përgjigja e saktë është alternativa A

8. Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtim me parimin e konfidencialitetit;

- a. edhe pas përfundimit të marrëdhënieve midis profesionistit kontabël dhe klientit
- b. gjatë periudhës së angazhimit
- c. të dyja së bashku
- d. asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa C

9. Një auditues ligjor ka vendosur që nga viti 2020 të mos e ushtrojë profesionin dhe të kalojë në statusin pasiv. Në lidhje me auditimet e kryera prej tij, duhet të:

- a. ruaj konfidencialitetin edhe gjatë periudhës kur nuk e ushtron profesionin-auditues ligjor
- b. prodhojë dokumentacione vetëm në rastet kur e detyron një akt ligjor i veçantë
- c. të dyja të së bashku
- d. asnjëra nga të mësipërmet sepse ai gjendet në statusin pasiv (*mos ushtrim i profesionit*)

Përgjigja e saktë është alternativa C

10. Sipas teorisë së kujdesit të duhur, kujdesi i prodhuesit duhet të tregohet në të gjitha përveç:

- a. kontrollit të cilësisë që teston prodhimin
- b. zgjedhjes së materialeve të besueshme për konstruksionin e produktit
- c. konstruksionit të produktit
- d. kontrollit të cilësisë që monitoron prodhimin
- e. tabelave paralajmëruese për prodhimin/produktin
- f. instruksioneve që duhet të shoqërojnë produktin
- g. kontrollit të çmimit të produktit që i ofrohet klientëve
- h. të gjitha

Përgjigja e saktë është alternativa G

PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Drejtorët jo - ekzekutivë luajnë një rol kyç për sa i takon eliminimit të konflikteve të interesit midis menaxhmentit (përfshirë këtu dhe drejtorët ekzekutivë) dhe aksionarëve, duke mbajtur kështu një pozicion balancues të influencave.

Shpjegoni rolin e drejtorëve jo – ekzekutivë në sigurimin e një qëverisje të mirë të korporatës.

Zgjidhje:

Raporti Higgs në Mbretërinë e Bashkuar liston rolet kryesore të drejtorëve jo – ekzekutivë:

- i. **Roli Strategjik.** Drejtorët jo - ekzekutivë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të kontribuojnë në suksesin strategjik të korporatës, të sfidojnë strategjinë ekzistuese të saj si dhe të ofrojnë këshilla në këtë drejtim.
 - ii. **Roli Mbikëqyrës.** Drejtorët jo - ekzekutivë duhet të mbikëqyrin nga afër performancën e menaxherëve ekzekutivë për sa i takon përmbushjes së synimeve dhe objektivave të tyre; si dhe të monitorojnë raportimin e performances nga ana e tyre. Ata duhet të vendosin kolegët ekzekutivë përpara përgjegjësisë mbi vendimet e marra dhe rezultatet e arritura. Drejtorët jo - ekzekutivë duhet të përfaqësojnë interesat e aksionarëve duke siguruar se problemet e agjencisë nuk dalin në pah duke zvogëluar kështu vlerën e aksionarëve
 - iii. **Rreziku.** Drejtorët jo - ekzekutivë duhet sigurohen lidhur me saktësinë e informacioneve financiare dhe me sigurinë e kontrolleve të brendshme të raportimit financiar. Ata duhet të sigurohen se kompania ka sisteme të përshtatshme të kontrolleve të brendshme si dhe sisteme të menaxhimit të rreziqeve.
 - iv. **Njerëzit.** Drejtorët jo - ekzekutivë janë përgjegjës për përcaktimin e niveleve të duhura të kompensimit për ekzekutivët. Ata janë figurat kyçe në emërimin në detyrë dhe largimin nga detyra të menaxherëve kryesore.
2. Shumica e parimeve që zbatohen për qeverisjen e korporatave në të njëjtën kohë mund të zbatohen edhe ndaj korporatave të sektorit publik.

Shpjegoni KATËR elemente si manifestohet qeverisja e korporatave në korporatat e sektorit publik.

Zgjidhje:

Kompanitë e sektorit publik ndyrshojnë nga llojet e tjera të organizatave, për shkak të elementëve të tillë si pronësia e tyre, arsyeja e ekzistencës së tyre dhe mjedisi ligjor ose rregullativ në të cilin ato veprojnë. Megjithatë, në ngjashmëri me qeverisjen e korporatave në sektorin privat, Bordeve të korporatave në sektorin publik i kërkohet të **veprojnë me integritet, të respektojnë parimet e ndërshmërisë, transparencës dhe drejtësisë; të mbikëqyrin siç duhet aktivitetet e organizmave të tyre udhëheqës (pra drejtuesit); të sigurohen mbi përshtatshmërinë e sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe menaxhimit e duhur të rrezikut si dhe të krijojnë dhe vënë në funksion sistemet e duhura të raportimit.**

Disa karakteristika të qeverisjes së korporatave në sektorin publik përfshijnë:

- **Përbërja e bordeve.** Madhësia e bordit si dhe përbërja e tij përcaktohet me anë të akteve nënligjore apo rregulloreve; dhe/ ose mund të rregullohet me anë të aktit të themelimit të korporatës publike (shoqërisë publike).
- **Nënshtrimi ndaj kontrolleve dhe mënyra e sjelljes së drejtorëve.** Drejtorët duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të ushtruara nga vetë korporata (pra auditimeve të brendshme) si dhe kontrolleve nga organizma të tjerë publike që janë specifike për sektorin. Ushtrimi i këtyre kontrolleve do të japë siguri se drejtorët veprojnë në interes të publikut.
- **Rregulloret e detyrueshme kundrejt praktikave më të mira vullnetare.** Ato të cilat mund të përbëjnë praktikën më të mira vullnetare në sektorin e korporatave private mund të jenë të detyrueshme për korporatat publike, për shembull, vënia në funksion e një departamenti të auditimit të brendshëm është i detyrueshëm për sektorin publik ndërkohë që konsiderohet praktike e mirë për një pjesë të korporatave në sektorin privat.
- **Dhënia e shpjegimeve për kontrollet e brendshme dhe performancën.** Korporatave publike iu kërkohet të japin shpjegime rreth sistemeve të kontrolleve të brendshme për manaxhimin e rrezikut, të tilla si regjistrat për vlerësimin e rreziqeve, trajnimet si dhe treguesit kyç të performancës të shoqërisë.

3. Diskutoni rolin dhe funksionin e komitetit të emërimeve në kuadër të qeverisjes së korporatës.

Zgjidhje:

Në mënyrë që të sigurohet dhe të ruhet një balancë e duhur pjesëmarrjesh në bord mes drejtorëve ekzekutivë dhe atyre jo-ekzekutivë, kodet e qeverisjes së korporatës rekomandojnë që bordi të themelojë një komitet të emërimeve (pra një komitet në nivel bordi), i cili duhet të i) **japë rekomandime ndaj bordit, për kandidatët që do të emërohen në detyrë si drejtorë të rinj;** si dhe të ii) **mbikëqyrë procesin e emërimit të anëtarëve të rinj bordit. (1 pikë)**

Kodet e qeverisjes së korporatës rekomandojnë që **komiteti i emërimeve të përbëhet nga anëtarë jo – ekzekutivë**, duke siguruar kështu një **shkallë të lartë të pavarësisë nga drejtuesit ekzekutivë**, dhe duke mos ushtruar influencë përmes rekomandimeve të tyre. **(1 pikë)**

Komiteti i emërimeve duhet të mbajë parasysh ndër të tjera, dhe disa çështje të tilla të rëndësishme për sigurimin e qeverisjes së mirë të korporatës, si: i) balancën midis drejtorëve ekzekutivë dhe drejtorëve të pavarur jo – ekzekutivë; ii) aftësitë, njohuritë dhe eksperiencën që zotërohet nga bordi aktual; iii) nevojën për vazhdimësi të bordit (përmes planifikimit dhe propozimit të emërimeve të reja apo ri-emërimeve në përfundim të mandateve); iv) madhësinë e dëshiruar të bordit; si dhe nevojën për të tërhequr anëtarët e bordit nga një shumëllojshmëri ekspertizash dhe eksperiencash të cilat kanë relevancë të lartë me industrinë në të cilën operon korporata. **(1 pikë)**

Kodet e qeverisjes së korporatës theksojnë se komiteti i emërimeve duhet të rishikojë rregullisht strukturën, madhësinë dhe përbërjen e bordit. Në të njëjtën kohë duhet të mbahet

parasysh edhe fakti nëse drejtorët jo - ekzekutivë janë duke i kushtuar kohë të mjaftueshme detyrave të veta dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me ri – zgjedhjen dhe ri – emërimin e drejtorëve, bashkë me anëtarësinë e komiteteve të bordit. **(1 pikë)**

4. Shpjego kërcënimin e familjaritetit dhe kërcënimin e frikësimit.

Zgjidhje:

Kërcënimi i familjaritetit – kërcënimi, që për shkak të një marrëdhënie të gjatë ose të afërt me një klient ose një punëdhënës, një profesionist kontabël do të bëhet shumë dashamirës (do të tregojë shumë simpati) ndaj interesave të tyre, apo ndaj pranimin të punës së tyre dhe rrjedhimisht nuk do jete ne pajtueshmeri me parimet themelore te pavaresise.

Kërcënimi i frikësimit – kërcënimi që një profesionist kontabël do të pengohet në kryerjen e veprimtarisë së tij me objektivitet për shkak të presioneve aktuale ose të perceptuara, përfshirë këtu përpjekjet për të ushtruar influencë të panevojshme mbi profesionistin kontabël dhe rrjedhimisht nuk do jete ne pajtueshmeri me parimet themelore te pavaresise.

5. Perkufizo cfare eshte pavaresia ne angazhimet e auditimit dhe ne angazhime te tjera te rishikimit?

Zgjidhje:

Pavarësia lidhet me parimet e objektivitetit dhe integritetit. Ajo përfshin:

(a) Pavarësinë e Mendimit – gjendja e të menduarit, që lejon shprehjen e një konkluzioni pa u ndikuar nga influencat që kompromentojnë gjykimin profesional, me anën e të cilës bëhet e mundur që një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin dhe skepticizmin profesional.

(b) Pavarësinë në Dukje (Aparencë) – mënjanimi i fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme, sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, e cila peshon të gjitha faktet dhe rrethanat specifike, do të mund të arrinte në përfundimin se është kompromentuar integriteti, objektiviteti ose skepticizmi profesional i një firme apo të një anëtarit të grupit të auditimit.

6. Shpjego se si një marrëdhënie e ngushtë biznesi me një klient të auditimit ose drejtimin e tij, mund të krijojë një kërcënim të egoizmit ose të frikësimit?

Zgjidhje:

Një marrëdhënie e ngushtë biznesi me një klient të auditimit ose drejtimin e tij, mund të krijojë një kërcënim të egoizmit ose të frikësimit. Shembuj të një marrëdhënieje të ngushtë biznesi që lindin nga një marrëdhënie tregtare ose interesa të përbashkëta financiare, përfshijnë:

- Ekzistencën e një interesi financiar në një sipërmarrje të përbashkët me klientin ose me një pronar kontrollues, drejtor, zyrtar ose individë të tjerë, të cilët kryejnë veprimtari të drejtimin të lartë për atë klient. Nëse interesi financiar do ishte material, kjo do*

krijonte nje kercenim te egoizmit per arsye se mund te influencojë në mënyrë të papërshtatshme gjykimin ose sjelljen profesionale të profesionistit kontabël;

- *Marrëveshjet për të kombinuar një apo më shumë shërbime ose produkte të firmës ose të një firme rrjet, me një ose më shumë shërbime apo produkte të klientit dhe tregtimi i paketës me referim tek të dyja palët. Nese keto marreveshje do te ishin te rendesishme dhe nuk do te bazohen ne rrjedhen normale te biznesit apo nuk do te jene ne kushte te tregut por ne kushte preferenciale, do te influencojë në mënyrë të papërshtatshme gjykimin ose sjelljen profesionale të profesionistit kontabël ose do te krijojne pengese në kryerjen e veprimtarisë së tij me objektivitet për shkak të presioneve aktuale ose të perceptuara, përfshirë këtu përpjekjet për të ushtruar influencë të panevojshme mbi profesionistin kontabël.*
 - *Marrëveshjet e shpërndarjes ose të marketingut, sipas të cilave firma shpërndan ose tregon produktet apo shërbimet e klientit ose klienti shpërndan apo tregon produktet ose shërbimet e firmës ose një firmë rrjet. Nese keto marreveshje do te ishin te rendesishme dhe nuk do te bazohen ne rrjedhen normale te biznesit apo nuk do te jene ne kushte te tregut por ne kushte preferenciale, do te influencojnë në mënyrë të papërshtatshme gjykimin ose sjelljen profesionale të profesionistit kontabël ose do te krijoje pengese në kryerjen e veprimtarisë së tij me objektivitet për shkak të presioneve aktuale ose të perceptuara, përfshirë këtu përpjekjet për të ushtruar influencë të panevojshme mbi profesionistin kontabël.*
7. Tregoni shkurtimisht çfarë është parashikuar në Kodin Ndërkombëtar të Etikës në rastin e kur një profesionist kontabël identifikon shkelje të Kodit ? A duhet të raportohet nga profesionisti kontabël një shkelje e tillë ? Nëse Po Kujt?

Zgjidhje:

Një profesionist kontabël, i cili identifikon një shkelje të ndonjë dispozite të Kodit do të vlerësojë rëndësinë e shkeljes dhe ndikimin e saj në aftësinë e profesionistit kontabël për të përmbushur parimet themelore. Profesionisti kontabël gjithashtu do të:

- (a) *Ndërmarrë çfarëdo veprimi që mund të jetë në dispozicion, sa më shpejt të jetë e mundur, për të adresuar në mënyrë të kënaqshme, pasojat e shkeljes; dhe*
- (b) *Vlerësojë nëse do ta raportojë shkeljen tek palët përkatëse.*

Palët përkatëse tek të cilat mund të raportohet një shkelje e tillë, përfshijnë ato të cilat mund të jenë prekur nga shkelja,

një organ profesional ose rregullator ose një autoritet mbikëqyrës.

8. Shpjegoni shkurtimisht parimin e kompetencave profesionale dhe të kujdesit të duhur duke evidentuar edhe një shembull.

Zgjidhje:

Parimet themelore të etikës përcaktojnë standardin e sjelljes që pritet të zbatohet nga një profesionist kontabël, midis tyre edhe parimin “Kompetenca Profesionale dhe Kujdesi i Duhur”. Në kryerjen e shërbimeve profesionale, një auditues duhet;

- (i) Të arrijë dhe të mbajë njohuritë dhe aftësitë profesionale në nivelin e kërkuar, për të garantuar që një klient ose organizata punëdhënëse marrin shërbime profesionale kompetente, të cilat bazohen në standardet aktuale teknike e profesionale dhe në legjislacionin përkatës, dhe
- (ii) Të veprojë me kujdes dhe në pajtim me standardet e zbatueshme profesionale dhe teknike.

Mbajtja e kompetencës profesionale kërkon një ndërgjegjësim të vazhdueshëm dhe njohjen e standardeve përkatëse teknike e profesionale dhe zhvillimeve të biznesit. *Zhvillimi dhe edukimi i vijueshëm profesional i jep mundësi profesionistit kontabël të zhvillojë dhe të mbajë aftësitë profesionale për të ofruar shërbime me kompetencë dhe brenda mjedisit profesional.*

9. Shpjegoni shkurtimit kërcënimin e frikësimit dhe rrethanat që mund ta shkaktojnë. Evidentoni disa masa mbrojtëse që mund të ndërmerren. Tregoni një shembull mbi shfaqjen e këtij kërcënimi.

Zgjidhje:

Kërcënimi i frikësimit, është kërcënimi që një auditues ligjor apo profesionist kontabël do të pengohet në kryerjen e veprimtarisë së tij me objektivitet për shkak të presioneve aktuale ose të perceptuara, përfshirë këtu përpjekjet për të ushtruar influencë të panevojshme mbi audituesin ligjor apo profesionistin kontabël.

Masat mbrojtëse janë veprime, individuale ose të kombinuara, që profesionisti kontabël ndërmerr, të cilat efektivisht reduktojnë kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore në një nivel të pranueshëm. Në varësi të fakteve dhe rrethanave, një kërcënim mund të trajtohet duke eliminuar rrethanat që krijojnë kërcënimin. Sidoqoftë, ekzistojnë disa situata në të cilat kërcënimet mund të trajtohen vetëm duke refuzuar ose duke mos vazhduar aktivitetin specifik profesional. Kjo për shkak se rrethanat që krijojnë kërcënimet nuk mund të eliminohen dhe masat mbrojtëse nuk janë në gjendje të zbatohen për të reduktuar kërcënimin në një nivel të pranueshëm. Masat mbrojtëse që vëndosen në mjedisin e punës, ndryshojnë sipas rrethanave. Në këto masa mbrojtëse përfshihen

- (i) masat mbrojtëse që janë të përgjithëshme, dhe
- (ii) masat mbrojtëse që i përkasin një angazhimi të veçantë.

Në masat mbrojtëse që vëndosen në mjedisin e punës, bëjnë pjesë midis tjerave;

- Vëndosja e politikave të dokumentuara që shërbejnë: për të identifikuar kërcënimet që i bëhen respektimit të parimeve themelore, për vlerësimin e rëndësisë së kërcënimeve dhe për identifikimin e zbatimit të atyre masave mbrojtëse, të cilat eliminimojnë apo zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm, përveç rasteve kur kërcënimet janë krejt të parëndësishme.
- Vëndosja e politikave dhe procedurave që bëjnë të mundur identifikimin e interesave ose marrëdhënieve që ekzistojnë midis firmës apo anëtarëve të grupeve të angazhimit dhe klientëve.
- Vëndosja e politikave dhe procedurave të publikuara, që shërbejnë për të inkurajuar dhe për t'i dhënë pushtet personelit të firmës së auditimit, me qëllim që ai të komunikojë me nivelet e larta brenda firmës, për çdo çështje shqetësuese që ka lidhje me respektimin e parimeve themelore.

- Konsultimi me një palë të tretë të pavarur, siç mund të jetë një komitet i pavarur i drejtorëve, një organizim profesional ose rregullator, apo edhe një auditues ligjor tjetër.
- Etj

Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë kërcënimin e frikësimit, por pa u kufizuar vetëm në këto, janë:

• Kërcënimi me largim ose zëvendësim të audituesit ligjor nga angazhimi i tij tek një klient.

- Kërcënimi me padi gjyqësore.
- Presioni për të zvogëluar në mënyrë të papërshtatëshme nivelin e punës së kryer, me qëllim që të zvogëlohen honoraret e pagesës.

Një profesionist kontabël ose një anëtar i drejtpërdrejtë ose i afërt i familjes, përballet me kërcënimin e largimit nga puna apo zëvendësimit për shkak të një mosmarrëveshjeje lidhur me:

- Zbatimin e një parimi kontabël.
- Mënyrën se si duhet të raportohet informacioni financiar.

Një individ kërkon të influencojë procesin e vendimmarrjes të profesionistit kontabël, për shembull, në lidhje me dhënien e kontratave ose zbatimin e një parimi kontabël.

10. Tek etika e biznesit, çfarë kuptoni me Ç'orientim (keq udhëzim) menaxherial dhe Konfuzion moral. Tregoni disa nga praktikat diskriminuese në punë dhe argumentoni pse ato janë diskriminuese?

Zgjidhje:

Ç'orientim (keq udhëzim) menaxherial ... fushe e etikes që merret me analizen dhe vlerësimin e praktikave të paligjshme, jo etike apo të dyshimta të menaxhereve individuale, dhe të organizatës së biznesit, shkaktohet që kanë çuar në këto sjellje, si dhe mjetet që duhet të përdoren për t'i korrigjuar.

Konfuzion moral ... fushe e trajtuar nga etika e biznesit që përfshijnë një mori problemesh etike mëtej cilat menaxheret merren pothuaj çdo ditë, të tilla si konflikti potencial i interesave, përdorimi i gabuar i burimeve të kompanisë, keqmenaxhimi i kontratave dhe marrëveshjeve, etj.

Disa nga praktikat diskriminuese në punë:

- *Praktikat e marrjes në punë.* Organizatat e biznesit që për rekrutimin e punonjësve të rinj mbështeten vetëm në referencat gojore të atyre që njohin, synojnë që në këto organizata të punesohen vetëm ata individë që ju përkasin grupeve raciale apo seksuale që janë përfaqësues të forcës punëtore aktuale. Kur fuqia punëtore përbehet vetëm nga burra të racës së bardhë, këto politika të marrjes në punë do të diskriminojnë gratë dhe minoritetet; etj.
- *Praktikat e shqyrtimeve të hollesishme (ose ndryshe praktikat mbuluese).* Kualifikimet që iu kerkohen aplikantëve për të punësuar janë diskriminuese kur ato nuk kanë të bëjnë fare ose kanë të bëjnë fare pak me punën që do të kryhet, p.sh. shpallja e kërkesës që për të punësuar në disa pozicione punë kerkohet arsim i lartë, kur në të vërtetë nuk ka aspak nevojë për këto lloje edukimi arsimor ose përdorimi i kritereve të shumta kualifikuese kur në aplikantëve është shumë i kufizuar, etj.

- *Praktikat promociionale.* Promocioni, progresi ne pune dhe praktikat e transferimit jane diskriminuese kur ato iu japin me teper mundesi burrave kundrejt grave dhe grupeve te minoriteteve. Sistemi i bazuar ne vjetersine ne pune behet diskriminues kur nuk i lejon grate dhe minoritetet te perparojne ne punen e tyre.
- *Kushtet e punesimit.* Diskriminimi ekziston edhe ne rastin e dhenies se pagave apo te shperblimeve te diferencuara, ku personave qe bejne te njejten pune, iu jepen shperblime te ndryshme.
- *Pushimet e padrejta nga puna ...* bazuar ne racen, seksin apo shkaqe te tjera te palidhura me performancen e tij, qe eshte nje forme tjeter e paster e diskriminimit.

USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

Ushtrimi 1

Bordi i Drejtorëve (Këshilli Drejtues) është një nga funksionet më të rëndësishme në kuadër të qeverisjes së korporatave. Që Bordi të veprojë me efektivitet, roli i tij duhet të përkufizohet me kujdes.

Shpjegoni dhe vlerësoni rolin dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve (Këshillit Drejtues).

Zgjidhje:

Raporti Higgs ofron këtë përkufizim për rolin e bordit: ‘Bordi është përgjegjësia kolektive për **promovimin e suksesit të kompanisë nëpërmjet drejtimit dhe mbikëqyrjes së punëve të saj.** Roli i bordit është të ofrojë leadership sipërmarrës për kompaninë, brenda një kornize të matur dhe efektive të kontrolleve të brendshme e cila mundëson vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut’. Ose raporti i Mbretit të Afrikës së Jugut (South African King Report), i cili citon: ‘Roli i bordit është të përkufizojë qëllimet dhe vlerat nga të cilat kompania do të sigurojë ekzistencën e saj të përditshme dhe të identifikojë palët e interesuara që kanë të bëjnë me biznesin e kompanisë. Më pas bordi duhet të zhvillojë një strategji në të cilën kombinohen të tre këta faktorë dhe të bëjë të sigurt se menaxhmenti zbaton strategjinë në fjalë.’

Bordi duhet të **caktojë vlerat dhe standardet e kompanisë** dhe të bëjë të sigurt se të gjitha detyrimet e kësaj të fundit ndaj palëve të saj të interesuara dhe palëve të tjera kuptohen dhe përmbushen siç duhet.

Bordi duhet të jetë përgjegjës për marrjen e vendimeve të rëndësishme për sa i takon politikave dhe strategjive. Këto vendime, të cilat janë të rezervuara vetëm për nivelin e bordit, merren përmes takimeve të bordit. Vendime të tilla përfshijnë investime në blerje apo bashkime kompanish, shtime apo pakësime të aktiveve materiale, financime strategjike etj.

Bordi është përgjegjës për për monitorimin efektiv të menaxhmentit dhe performancës së saj duke vendosur në rradhë të parë interesat e aksionarëve. Anëtarët e bordit duhet të veprojnë duke qenë plotësisht të informuar, me mirë - besim , me kujdesin e dilijencën e duhur si dhe në interesin më të mirë të kompanisë dhe aksionarëve të saj.

Disa nga detyrat e tjera të Bordit përfshijnë, i) përzgjedhja, emërimi, dhe monitorimi i Drejtorit Ekzekutiv, vendosja dhe monitorimi i rreziqeve, sistemeve të kontrollit dhe qeverisjes; monitorimi i aspekteve të kapitalit njerëzor të kompanisë, menaxhimi i konflikteve të mundshme të interesit etj.

Ushtrimi 2

Drejtorët jo-ekzekutivë luajnë një rol kyç për sa i takon eliminimit të konflikteve të interesit midis menaxhmentit dhe aksionarëve, duke ofruar siguri për aksionarët që menaxhmenti është duke vepruar në interes të kompanisë. Drejtorët jo-ekzekutivë duhet në cdo kohë të mbeten të pavarur.

Cilat do të ishin PESË masa mbrojtëse që do të sygjeroni për të siguruar që drejtorët jo - ekzekutivë mbeten të pavarur.

Zgjidhje:

Për t'u siguruar që drejtorët jo - ekzekutivë mbeten të pavarur, mund të merren një sërë masash mbrojtëse. Masat e sugjeruara nga raportet e qeverisjes së korporatës përfshijnë:

- i. Drejtorët jo - ekzekutivë nuk duhet të kenë lidhje tregtare, financiare ose lidhje të tjera me kompaninë, përveç pagesave që marrin prej saj.
- ii. Postet e tërthorta të drejtorëve nuk duhen lejuar. Ky është rasti kur drejtori ekzekutiv i Kompanisë A bëhet drejtor jo - ekzekutiv i Kompanisë B, dhe drejtori ekzekutiv i Kompanisë B bëhet drejtor jo - ekzekutiv në Kompaninë A. Ky është një kërcënim domethënës ndaj pavarësisë dhe konflikt i qartë interesi. Kjo pasi drejtorët do të vlerësojnë njëri tjetrin apo marrin vendime për njëri tjetrin (përfshirë këtu dhe vendimet për kompensime), duke u bërë kështu shkak që ata të shohin njëherë interesin e vet personal e pastaj atë të aksionarëve.
- iii. Drejtorët nuk duhet të marrin pjesë në skemat e kompensimit me aksione, për të ruajtur kështu statusin e tyre të pavarur.
- iv. Emërimet në detyrë duhet të bëhen për një afat të përcaktuar mirë dhe ri - emërimet në detyrë nuk duhet të jenë automatike. Bordi si një i tërë duhet të marrë vendime mbi emërimet dhe zgjedhjen e drejtorëve.
- v. Duhet të ketë procedura të caktuara sipas të cilave drejtorët jo - ekzekutivë mund përftojnë këshilla nga persona të pavarur, me shpenzimet e kompanisë në qoftë se kjo është e nevojshme.

Ushtrimi 3

Bordi i drejtorëve duhet të jetë përgjegjës për marrjen e vendimeve të rëndësishme për sa i takon politikave dhe strategjive të kompanisë.

- a. Listoni PESË nga çështjet më kyçe të kompanisë për të cilat vendimet merren prej bordit. (2.5 pikë)
- b. Listoni PESË detyra të bordit të drejtorëve. (2.5 pikë)

Zgjidhje:

- a) Disa prej vendimeve më kyçe, vendimet për të cilat merren nga Bordi, përfshijnë:
 - i) Blerjet dhe bashkimet e kompanive,
 - ii) Blerjet dhe shitjet e pasurive të paluajtshme të kompanisë ose të filialeve të saj, të cilat janë materiale për kompaninë;
 - iii) Investimet apo projektet kapitale;
 - iv) Mundësitë e marrjes hua prej bankave dhe institucioneve financiare, kreditë dhe shlyerjet e tyre;
 - v) Transaksionet në valutë të huaj.
- Të gjitha këto, pasi kalohet një limit i caktuar monetar (i cili gjithashtu përcaktohet nga bordi).

Shembuj të tjera të vendimeve të bordit të drejtorëve mund të listohen, deri në PESË tipe vendimesh.

- b) Disa nga detyrat kryesore të bordit të drejtorëve përfshijnë:
- c) Monitorimi i Drejtorit Ekzekutiv;
- d) Mbikëqyrja e strategjisë të korporatës;
- e) Monitorimi i rreziqeve, sistemeve të kontrollit dhe qeverisjes;
- f) Monitorimi i aspekteve të kapitalit njerëzor të kompanisë p. sh. vazhdimësia, morali, trajnimet, kompensimet etj;
- g) Bërja e sigurt se komunikimi i planeve strategjike, si së brendshmi dhe së jashtmi është efektiv;

Shembuj të tjera të detyrave të bordit të drejtorëve mund të listohen, deri në PESË detyra.

Ushtrimi 4

Ju jeni një menaxher auditimi në një shoqëri auditimi. Ju jeni duke përgatitur letrën e angazhimit për auditimin e Antike shpk, një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e cila ka si viti financiar 31 dhjetor 2020. Antike shpk është e rritur me shpejtësi gjatë viteve të fundit dhe tani është një nga klientët më të rëndësishëm të shoqërisë së auditimit. Antike shpk ka qenë klient auditimi për tetë vite dhe shoqëria e auditimit u ka ofruar shërbime të tjera si këshillime mbi tatimet dhe taksat dhe mbi çështje të ndryshme menaxhimi përgjatë 8 viteve. Klienti ka qenë i kënaqur me shërbimet e ofruara, megjithatë, tarifa për shërbimet e këshillimit tatimor për vitin financiar që mbyllet me 31 dhjetor 2019 ka mbetur e papaguar. Personeli i auditimit në dispozicion për auditimin e këtij viti është konsistente me stafin nga viti i kaluar, duke përfshirë partnerin e auditimit por edhe supervizorin e auditimit. Partneri i auditimit ka qenë cdo vit i përfshirë. Nga ana tjetër, vajza e partnerit të angazhimit është emëruar drejtoreshë financiare e Antike shpk së fundmi. Për të festuar emërimin e saj të ri, partneri i angazhimit ka sugjeruar të ftoje të gjithë stafin e auditimit për darke pranë një restoranti të shtrenjtë para fillimit të punës së auditimit për këtë vit.

Kërkohet: Identifikoni dhe shpjegoni rreziqet për pavarësinë që lindin gjatë kryerjes së auditimit tuaj të Antike shpk për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2020.

Zgjidhje:

Rreziqet për pavarësinë e auditimit të identifikuar nga rasti me lart, shpjegohen si më poshte vijon:

- 1- **Partneri i auditimit-** Partneri i auditimit në auditimin e Antike shpk ka qene i perfshire për tetë vitet e fundit. Pavarësia dhe objektiviteti ka të ngjarë të dëmtohen si rezultat i kësaj marrëdhënie të ngushtë me stafin drejtues të klientit dhe kërcënim i familjaritetit mund të jete i pranishem. Kercenimi i familjaritetit eshte kërcënim, që për shkak të një marrëdhënie të gjatë ose të afërt me një klient ose një punëdhënës, një profesionist kontabël do të bëhet shumë dashamirës (do të tregojë shumë simpati) ndaj interesave të tyre, apo ndaj pranimet të punës së tyre) dhe rrjedhimisht ekziston mundësia që mos të jete ne pajtueshmeri me parimet themelore te pavaresise.
- 2- **Honoraret e papagara-** Antike shpk nuk ka paguar ende honorarët lidhur me shërbimet keshillimore për vitin e kaluar dhe kjo ngjarje në thelb ekonomik do ishte si një hua pa interes që audituesi po i jep Shoqërisë Antike shpk. Kjo mund të kërcënojë pavarësinë dhe objektivitetin e firmës së auditimit dhe mund të krijojë një kercenim te egoizmit, pasi Shoqëria e Auditimit mund të mos dëshirojë të modifikojë opinionin e auditimit në rast se tarifat e papaguara nuk paguhen. Një kërcënim i egoizmit mund të krijohet nëse një pjesë e rëndësishme e honorareve nuk është paguar para lëshimit të raportit të auditimit për vitin vijues.
- 3- **Varësia nga tarifat-** Antike shpk është një nga klientët më të rëndësishëm të Shoqërisë së auditimit pasi përveç shërbimeve të auditimit ofrohen edhe shërbimet të këshillimit tatimor dhe taksave. Antike shpk po rritet me shpejtësi. Kur totali i pagesave nga një klient i auditimit, për firmën që shpreh opinionin e auditimit, përfaqëson një pjesë të madhe të totalit të honorareve të firmës, varësia nga ky klient dhe shqetësimi për humbjen e klientit, krijon një kërcënim të egoizmit (interesi vetjak) apo të frikësimit. Objektiviteti dhe pavarësia konsiderohen të kërcënohen deri në shkallën që një rishikues i pavarur është i nevojshëm nga një firmë ose rregullator i jashtëm.
- 4- **Marrëdhënia me Drejtorin Financiar të Antike shpk** - Vajza e partnerit të angazhimit është emëruar drejtore financiare e Antike shpk. Pavarësia e partnerit të angazhimit mund të kërcënohet për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare. Shkalla e kërcënimit varet nga pozicioni që mban anëtar i familjes me klientin dhe rolin e profesionistit në ekipin e auditimit. Si drejtore financiare, vajza e partnerit, ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi pasqyrat financiare, ndërsa partneri i angazhimit, ka përgjegjësinë e fundit për opinionin e auditimit, kështu që ekziston një kërcënim i qartë për objektivitetin dhe pavarësinë.
- 5- **Darka pranë një restoranti të shtrenjtë-** Fakti që partneri i angazhimit dëshiron ta marrë ekipin e auditimit për një darke të shtrenjtë para fillimit të auditimit mund të konsiderohet si një kërcënim për pavarësinë, pasi kjo mund të ndikojë në vendimet e ekipit të auditimit pasi të fillojnë auditimin e pasqyrave financiare.

Ushtrimi 5

Ju jeni një menaxher i auditimit të Ekspertit kontabel shpk dhe sapo ju është caktuar auditimi i Ksamil shpk. Partneri i angazhimit të auditimit i cili është përgjegjës për auditimin e Ksamil shpk, ka vepruar si i tillë për 3 vite rradhazi. Djali të partnerit sapo i është ofruar një rol në Ksamil shpk si menaxher shitjesh dhe skema e bonusit është në varësi të drejteperdrejte me vëllimin e shitjeve që do bëjë për turistët e ardhshëm. Drejtuesit e Ksamil shpk po konsideron krijimin e një funksioni të auditimit të brendshëm, dhe mendojnë që tja kërkojnë si shërbim shoqërisë së auditimit. Drejtori i finances i ka sugjeruar Dordit Drejtues që nëse Ekspertit

kontabel shpk emërohet si auditues i brendshëm por edhe si auditues i jashtëm, atëherë tarifat duhet të rinegociohen me të paktën 25% të të gjitha tarifave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm duke u bazuar në fitimin pas tatimit së shoqërisë, pasi kjo do të rriste eficientësinë e Ekspertet kontabel shpk dhe Ksamil shpk.

Kerkohe: Shpjegoni çfarë veprimesh do të ndërmerren për të eliminuar ose zbutur kërcënimet e pavarësisë që identifikoni nga skenari me lart?

Zgjidhje:

1-Ksamil shpk ka kërkuar që Ekspertet Kontabel të emërohet si auditues i brendshëm i Shoqërisë. Nëse shoqëria e auditimit do të pranojë dhe do të ofrojë shërbime të auditimit të brendshëm do të ekzistojë mundësia e kërcënimit të vetë rishikimit pasi ka gjasa që ekipi i auditimit do të kërkojë të mbështetet në sistemin e kontrollit të brendshëm të rishikuar nga auditimi i brendshëm. Faktorët që janë të përshtatshëm për vlerësimin e një kërcënimi të tillë të vetë rishikimit, përfshijnë:

- Materialitetin e shumave përkatëse në pasqyrat financiare
- Rrezikun e anomalisë së pohimeve të lidhura me shumën në pasqyrat financiare.
- Shkallën e besueshmërisë që grupi i auditimit do të vendosë mbi punën e shërbimit të auditimit të brendshëm, përfshirë atë gjatë një auditimi të jashtëm.

Masë mbrojtëse për zbutjen e këtyre kërcënimeve është përdorimi i profesionistëve, të cilët nuk janë anëtarë të grupit të auditimit, për të kryer shërbimin. Nderkohe që për entitetet me interes publik, veprimet për të eliminuar kërcënimet do të jenë refuzimi i dhenies së shërbimeve të auditimit të brendshëm.

2- Tarifat duhet të rinegociohen me të paktën 25% të të gjitha tarifave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm duke u bazuar në fitimin pas tatimit së Shoqërisë. Në këtë mënyrë tarifat llogariten dhe vendosen mbi një bazë të kushtëzuar dhe ngre një kërcënim të interesit vetjak pasi tarifa do të varet nga një ngjarje e ardhshme e cila shfaq pasiguri. Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimit të interesit vetjak përfshijnë:

- Angazhimin e një profesionisti të përshtatshëm, i cili nuk është përfshirë në kryerjen e shërbimit të sigurisë, për rishikimin e punës përkatëse të sigurisë.
- Marrjen në avancë të një marrëveshjeje të shkruar me klientin, për bazën e shpërblimit.

Shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren për të eliminuar kërcënimet do të ishin që Shoqëria audituese të refuzonte bazën e kushtëzuar të tarifave por, ta diskutonte me Klientin mbi mundësinë e vendosjes së një tarife fikse për llogaritjen mbi bazën e kohës dhe orëve të pritshme për të shpenzuar nga ekipi që do të kryejë shërbimin.

3-Djali të partnerit sapo i është ofruar një rol në Ksamil shpk si menaxher shitjesh dhe skema e bonusit është në varësi të drejteperdrejte me vëllimin e shitjeve që do të bëjë për turistët e ardhshëm. Nëse djali i partnerit të angazhimit pranon rolin si menaxher shitjesh dhe skema e bonusit është në varësi të drejteperdrejte me vëllimin e shitjeve që do të bëjë për turistët e ardhshëm, kjo do të përbëjë një kërcënim të interesit vetjak. Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimit të interesit vetjak përfshijnë:

- *Strukturimi i përgjegjësive të grupit të sigurisë në mënyrë që anëtar i grupit të sigurisë të mos trajtojë çështjet që janë brenda përgjegjësisë së familjarit të afërt.*
- *Shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren për të eliminuar kërcënimet do ishin që Partneri i Angazhimit për auditimin e pasqyrave financiare largohet dhe në vend të tij të caktohet një profesionist tjetër, i cili nuk ka lidhje familjare me drejtorin e shitjeve.*

Ushtrimi 6

Ju jeni një menaxher auditimi në Inovacion shpk, një firmë e madhe auditimi e cila është e specializuar në auditimin e industrive tregtare dhe shitësve me pakicë. Firma aktualisht kryen auditimin e Krako shpk, një shitës me pakicë të produkteve ushqimore të paketuara, por konkurrenti kryesor i Krako shpk, Distribucion shpk, i ka kërkuar firmës së auditimit për të vepruar si auditues ligjorë. Krako shpk është i shqetësuar se nëse Inovacion shpk auditon të dy kompanitë, atëherë informacioni konfidencial mund të kalojë te konkurenti. Partneri i angazhimit të auditimit për Krako shpk ka marrë pjesë për 6 vjet në atë rol. Krako shpk po i ofron Inovacion shpk një bonus prej 10% përveç tarifës së auditimit nëse auditimi i këtij viti mund të përfundojë brenda 1 jave pune. Kjo nxitje jepet për të zvogëluar kohën e përfshirjes së drejtorit të financave pasi ai është i zënë duke punuar në projekte të tjera me të rëndësishme për shoqërinë.

Kerkohe: Shpjegoni çfarë veprimesh do të ndërmerreni për të eliminuar ose zbutur kërcënimet e pavarësisë që identifikoni nga skenari me lart?

Zgjidhje:

- 1- *Drejtimi i Krako dhe Inovacion shpk si edhe komitetet e auditimit duhet të informohen dhe të merret pëlqimi i tyre. Ekipet e veçanta të auditimit duhet të përdoren për secilën prej kompanive duke përfshirë partnerët e auditimit dhe partnerët e pavarur të rishikimit. Marrëveshjet e konfidencialitetit duhet të nënshkruhen nga stafi që do marrë pjesë në auditimet ligjore me qëllim që të parandalohet aksesimi apo shpërndarja e paautorizuar e informacionit.*
- 2- *Partneri i angazhimit ka qenë i përfshirë për 6 vjet. Kur një individ është i përfshirë në një angazhim auditimi për një periudhë kohe të gjatë, mund të krijohen kërcënimet të egoizmit dhe familjaritetit, pasi mund të mos mbajë skepticizëm dhe objektivitet profesional.*

- *Një shembull i një veprimi që mund të eliminojë kërcënimet e familjaritetit dhe të egoizmit të krijuara nga përfshirja e një individi në një angazhim të auditimit për një periudhë kohe të gjatë, do të ishte rotacioni/largimi i individit nga grupi i auditimit.*

Shembuj të veprimeve që mund të jenë masa mbrojtëse për adresimin e këtyre kërcënimeve të familjaritetit dhe egoizmit përfshijnë:

- *Ndryshimin e rolit të individit në grupin e auditimit ose të natyrës dhe shtrirjes së detyrave që kryen individi.*
- *Angazhimin e një partneri rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ishte anëtar i grupit të auditimit për rishikimin e punës së individit.*
- *Kryerjen në mënyrë të rregullt të rishikimeve të pavarura të jashtme ose të brendshme të cilësisë së angazhimit.*

3- *Një bonus për të nxitur finalizimin e auditimit brenda një kohe të shkurtër krijon një kërcënim të interesit vetjak, pasi ekziston një rrezik që Shoqëria e auditimit të mos kryejë procedura të plota dhe të mjaftueshme me qëllim që të mbërrijë afatin e paracaktuar dhe rrjedhimisht mos të rrezikojë të humbasë klientin si rezultat i mospërmbushjes së afatit. Veprimet të cilat do të ndërmerren për të eliminuar ose zbutur kërcënimin do ishin:*

- *Diskutim paraprakisht me drejtimin e shoqërisë për të komunikuar planin e punës dhe afatet e paracaktuara. Nëse është e pamundur të dakordohet mbi afatin duhet diskutuar mbi modalitetet e kryerjes së vizitës së auditimit duke e ndarë në dy apo disa pjesë si për shembull vizite të ndërmjetme dhe vizite finale me qëllim që pjesa më e madhe e procedurave të kryhen në vizitën e ndërmjetme. Mund të diskutohet me Klientin edhe mbi mundësinë e alokimit të pikave të tjera të kontaktit përmes drejtorit të financës për të dhënë informacionet e nevojshme ekipit të auditimit.*
- *Oret e buxhetuara dhe të planifikuara në strategjinë e auditimit nuk duhen ndryshuar.*

Ushtrimi 7

Një auditues ligjor është duke kryer angazhimin tek Klienti M.E.R. shpk. Ndërkohë i është ofruar mundësia e dhënies në të njëjtën kohë edhe të shërbimit të auditimit të P.F. të shoqërisë K.C.K. Shpk. Të dyja shoqëritë janë në konflikt mbi marrëdhëniet financiare të kryjuara midis tyre dhe momentalisht janë edhe në proces gjyqësor. I ndodhur përpara këtyre fakteve audituesi ligjor i ka kërkuar një klientit M.E.R.shpk pëlqimin për të vepruar për shoqërinë K.C.K shpk dhe ky pëlqim nuk është dhënë.

A ka vepruar drejt audituesi ligjor duke pyetur shoqërinë M.E.R. shpk ? Tregoni si duhet të veprojë audituesi ligjor në lidhje me shërbimin e auditimit P.F. të shoqërisë K.C.K. Shpk? Çfarë është parashikuar në Kodin e etikës në rastet e çështjeve ku interesat respektive janë në konflikt?

Zgjidhje:

Në Kodin e Etikës është parashikuar në seksionin e konfliktit të interesit se kur një ekspert kontabël i regjistruar kryen shërbime për klientët, interesat e të cilëve janë në konflikt ose kur klientët kanë mosmarrëveshje me njëri tjetrin për çështjen ose transaksionin në fjalë që është objekt i angazhimit, atëherë mund të krijohet/ shfaqet një kërcënim ndaj objektivitetit ose konfidencialitetit.

Në paragrafin 22. 3 parashikohen masat mbrojtëse që duhet të ndërmerren midis të cilave parashikohet edhe njoftimi i klientit dhe marrja e pëlqimit prej tij. Gjithashtu parashikohet se kur një auditues ligjor i ka kërkuar një klienti pëlqimin për të vepruar për një palë tjetër (që mund të jetë ose jo një klient ekzistues), në një çështje ku interesat respektive janë në konflikt, dhe ky pëlqim nuk është dhënë, atëherë audituesi ligjor, nuk duhet të vazhdojë të veprojë për njërin nga palët në çështjen që çon në konflikt interes.

Për sa më sipër veprimet e audituesit janë korrekte dhe ai nuk duhet të lidhë kontratën e shërbimit me shoqërinë K.C.K. shpk, pasi aktualisht është duke kryer angazhimin e tij në subjektin M.E.R.Shpk.

Ushtrimi 8

Një auditues ligjor i regjistruar për herë të parë në IEKA, ka nënshkruar kontratën për të kryer auditimin e P.F të vitit 2020 të shoqërisë “Ndiej” Shpk. Gjatë negociatave për kryerjen e këtij shërbimi kishte evidentuar aftësitë e tij profesionale si edhe për ti shfaqur në nivele sa më të larta i kishte krahasuar me aftësitë profesionale të audituesit të mëparshëm që Shoqëria “Ndiej” shpk kishte pasur kontraktuar në vitin 2019, bazuar në disa tregues që ai çmoi si të rëndësishëm për ti krahasuar.

Tregoni bazuar në Kodin e Etikës veprimet e audituesit ligjor.

Zgjidhje:

Bazuar në Kodin e Etikës cdo auditues ligjor ka të drejtë të kryej reklamimin e shërbimeve profesionale që ai ofron dhe ai nuk duhet të diskreditojë profesionin. Audituesi ligjor duhet të jetë i ndershëm dhe i sinqertë dhe nuk duhet midis të tjerave

- Të bëjë referime nënçmuese apo krahasime të pa provuara me punën e të tjerëve.

Një auditues ligjor i regjistruar për herë të parë në IEKA, nuk mundet të kryej krahasime të aftësive profesionale me audituesin/t e mëparshëm, kur ushtrimi i profesionit të audituesit ligjor sapo ka nisur. Çdo auditues, duhet të reklamojë aftësitë e tij profesionale, duke u bazuar në disa tregues që ai vetë çmon të rëndësishme, por jo duke kryer krahasime të pa provuara me punën e të tjerëve.

Ushtrimi 9

Mario punon te kompania postare UPS. Pavarësisht çfarë thotë UPS: ‘siguria është e para’, menaxheri i kërkoi Marios që të plotësojë synimet/targetet të cilat mund të arrihen duke shkelur procedurat e sigurisë. Mario e ngriti këtë çështje të bashkëpunëtorët e tij, por ata i thanë që të rrinte ‘urtë e të mos ndihej’ ose mund të pushohej nga puna.

Çfarë do t’i sugjeronit Marios në këtë rast ... si të vepronte; argumentoni sugjerimin tuaj?

Zgjidhje:

Ajo që do i sugjerohej Marios është që procedurat e sigurisë kurre nuk duhet të kompromentohen. Ai duhet ta diskutojë situatën fillimisht me menaxherin e tij te kompanisë UPS ose me nivelin tjetër më lart te menaxhimit tek UPS.

Nese edhe pas ketyre takimeve, nuk ndihet i qete ose nese ai deshton ne marrjen e vemendjes nga menaxhimi, ai duhet te telefonoje Linjen e Gatishmerise te UPS (qe me siguri e ka) ose te kontaktoje me departamentin juridik/ligjor te UPS. Ne fund te fundit, UPS nuk besoj qe do te lejoje cdo ‘kundërsulm/hakmarrje’ kundrejt punonjesve qe ngrejne çështje me rendesi/te prekshme.

Ushtrimi 10

Dy kolegë po diskutojnë me njëri-tjetrin. Erioni citon që nëse një interes ose marrëdhënie me klientin e auditimit nuk ndalohet sipas Kodit (psh. Kodi nuk e përcakton/specifikon këtë fakt ose Kodi nuk ka dispozita që mund të zbatohen për analogji), kjo nënkupton që interesi ose marrëdhënia janë automatikisht të lejuara, kurse kolegja e tij, Jora thotë që interesi ose marrëdhënia nuk janë automatikisht të lejuara.

Cilin mendim mbështetni, të Erionit apo Jorës? Zgjeroheni përgjigjen tuaj.

Zgjidhje:

Mbeshtesim më shume mendimin e Jores. Referuar metodes te bazuar ne kuadrin konceptual qe jepet ne Kod, interesi ose marredhenia duhen vleresuar per te percaktuar nese ato perbejne kercenime ndaj pavaresise. Nese ndonje kercenim i krijuar nuk eshte ne nje nivel te pranueshem, atehere duhet te zbatohen masa mbrojtese per te eliminuar kercenimin ose per ta pakesuar ate ne nivel te ulet te pranueshem. Vetem atehere interesi ose marredhenia do te jene te lejuara.